

## Hyrje në HTML!

HTML është akronim i **HyperText Markup Language**. HTML është gjuha bazë në ndërtimin e websiteve. HTML është e thjeshtë për t'u mësuar. HTML u krijua nga Tim Berners-Lee në vitin 1991 por "HTML 2.0" ishte standarti i parë i HTML i cili u krijua në 1999. Një zgjerim i këtij versioni është "HTML 5" i publikuar në vitin 2012 i cili është edhe version aktual i HTML-së.

## Cfarë na duhet për të punuar me HTML?

Gjithçka na duhet për të punuar me HTML është një **editor tekst** dhe një **browser**.

Programi në të cilën shkruhen taget HTML quhen **Editorë**. Nga vetë fjala **Editor** kemi të bëjmë me editimin, shkrimin e tageve HTML. Në windows kemi editorin **Notepad**, në **Mac TextEdit**, ka edhe shumë editorë të tjerë profesional si **Adobe Dreamweaver** por që nuk janë falas. Pasi kemi shkruar taget në HTML, fajlën e ruajmë me prapashtesën **.html ose htm**, ashtu siç një fajl në word ruhet me **.doc**. Këtë fajl e hapim me një **browser** çfarëdo për shembull **Google**, **Mozilla** etj.

Pra HTML është një gjuhë logjike e thjeshtë që kërkon vetëm dy gjëra:

- **Editor**
- **Browser**

Ndiqui katër hapat e mëposhtme për të ndërtuar faqen tuaj të parë në Notepad:

### Hapi 1: Hap Notepad

### Hapi 2: Shkruaj kodet si në vijim në HTML

### Hapi 3: Ruaje faqen HTML

Ruajeni në kompjuterin tuaj, për shembull me emrin **index.html**.

### Hapi 4: Hap faqen që krijove me një Browser

Gjatë shpjegimit këtu është përdorur **editori Brackets** të cilin mund ta shkarkoni falas në <http://brackets.io> dhe ta instaloni në kompjuterin tuaj.

## HTML Bazë

HTML është gjuha bazë e ndërtimit të strukturës së faqeve web.

Ajo nuk është një gjuhë e mirëfilltë programimi, quhet ndryshe **gjuhë taguese** sepse përdor taget për ndërtimin e strukturës së faqeve **web**.

Hapim një editor teksti dhe shkruajmë Faqen tonë të parë në HTML. Shkruani kodet si në figurë dhe do të fillojmë shpjegojmë çdo rresht të tyre me radhë. Pasi të shkruani taget html si më poshtë ruajeni me prapashitesën .html ose .htm duke zgjedhur opsionin **All Files**.

```
<!DOCTYPE html>
<html>

  <head>

    <title>Mirësevini në HTML</title>

  </head>

  <body>

    Këtu shkruhet përmbajtja web që do të shfaqet në browser.

  </body>
</html>
```

## Prezantimi në Browser

Pasi ta keni ruajtur filen tuaj të parë në **html si index.html**, klikoni me të djathtën e mousit dhe zgjidhni opsionin **open with Google** ose ndonjë browser tjetër. Pasi taget html procesohen nga browseri (shfletuesi web) do të na shfaqet pamja si në figurë. OK, ju sapo keni testuar kështu webin tuaj të parë!



Pra, brenda dritares së browserit është shfaqur vetëm teksti i cili gjendet midis tageve <body> dhe </body> , dhe si titull i tabit të hapur në browser teksti midis tageve <title> dhe </title>. Taget kryesore që mbështjen kodin në html janë <html> dhe </html>. Tagu <!DOCTYPE

html> në krye të kodeve html i tregon browserit se ka për të procesuar versionin HTML 5 të html-së. Taget në html janë hapëse për shembull <html>, mbyllëse </html> dhe vetëmbyllëse <br/>.

Theksojmë se HTML nuk është **Case Sensitive** që do të thotë në qoftë se ju shkruani <HTML> dhe <html> nuk përben problem megjithatë rekomandohet të përdoni emërimin e tageve me **shkronja të vogla**.

Përdor tage (<emriTagut>) për identifikimin e përmbajtjes.

Një shembull i tagut html:

```
<p> Ky është një paragraf </p>
```

Të gjithë dokumentet HTML duhet të fillojnë me një deklarinim tipi si : **<!doctype html>** . Ky deklarinim tipi i tregon browserit se ka të bejë me shfaqjen e tageve në versionin HTML5, që është edhe versioni i fundit i HTML-s.

Ndërsa dokumenti HTML më vete fillon me tagun <html> dhe mbaron me tagun </html>. Pjesa e dukshme e dokumentit është midis tageve <body> dhe </body>.

HTML nuk është Case Sensitive që do të thotë se <HTML> dhe <html> është i njëjti tag. Taget në HTML ndahen në tage **hapëse <html>, mbyllëse </html> dhe vetëmbyllëse <br/>**.

**Kujdes!!!**

*“Taget html që hapen të parat mbyllen të fundit.” Për shembull po të vini re tagun hapës <html> i cili hapet i pari dhe mbyllet i fundit </html>*

Për përcaktimin e kreut përdorim HTML headings të përcaktuar me taget nga <h1> dhe <h6>.

Për shembull:

**Këtu është përdorur h1**

**Këtu është përdorur h2**

**Këtu është përdorur h3**

**Këtu është përdorur h4**

**Këtu është përdorur h5**

**Këtu është përdorur h6**

## Linket HTML

Për përcaktimin e një linku përdoret tagu `< a >`. Adresa e linkut është specifikuar në atributin **href**. Atributet përdoren për informacione shtesë rreth elementeve html.

Për shembull:

```
<a href="http://www.google.com"/> Ky është link </a>
```

## Paragrafët HTML

Për përcaktimin e një paragrafi përdoret **tagu hapës** `<p>` dhe **tagu mbyllës** `</p>`.

Për shembull:

```
<p> Ky është paragraf.</p>
```

## Imazhet në HTML

Për imazhet përdoret tagu **vetëmbyllës** `<img>`. Ku **src** (burimi ose rruga për tek fajla), **alt** (teksti alternativ), **width dhe height** (përmasat të figurës) janë attribute.

Për shembull:

```

```

Ku **src** (burimi ose rruga për tek fajla), **alt** (teksti alternativ), **width dhe height** (përmasat të figurës) janë attribute.

Elementeve HTML mund ti vendosim attribute. Atributet sigurojnë informacione shtesë perreth një elementi. Atributet specifikohen gjithmonë në tagun hapës, dhe gjithmonë kanë trajtën **emri="vlera"**.

Të gjithë elementët HTML mund të kenë attribute.

- Atributi *title* siguron info shtesë.
- Atributi *href* siguron info rreth adresës së linkeve.
- Atributi *width dhe height* siguron info rreth përmasave të imazheve.
- Atributi *alt* siguron tekst nqs nuk shfaqet imazhi.
- Atributi *href* siguron info rreth adresës së linkeve.

- f. Atributi *target* siguron hapjen e adresesse linkeve ne nje tab te ri ne browser.

## Struktura Web

HTML është gjuha bazë për ndërtimin e strukturës së përmbajtjeve të faqeve web.

**HTML:** Struktura

**CSS:** Prezantimi

**JavaScript:** Sjellja

**PHP ose të ngjashme:** Backend / Server

**CMS:** Content Management si Wordpress

---

## Tag <html>

Megjithëse HTML ka kaluar nëpër disa versione baza apo sintaksa e HTML-së ka mbetur e njëjtë.

I gjithë kodi html mbështillet nga taget e mëposhtme:

```
<html>
...
</html>
```

- **Tag <head>**

Ky tag ndjek menjëherë tagun hapës html, dhe ka tagun e vet hapës dhe mbyllës.

Brenda këtyre tageve shkruhen elementë jo **vizual** të cilat ndihmojnë në funksionimin e faqes.

```
<html>
  <head>
    .....
  </head>
</html>
```

---

## Tagu <body>

Taget body ndjekin taget head. Brënda këtyre tageve shkruhen të elementët visual të faqes web, si paragraphët, listat, imazhet, dhe linqet të cilët janë disa nga elementët kryesorë që mund të shkruhen brënda tageve body.

### **- Struktura bazë HTML:**

```
<html>
  <head>
  </head>
  <body>
  </body>
</html>
```


---

## Tag-u <title>

Ky tag përdoret për vendosjen e titullit të dritarës së tabit brënda së cilës do të shfaqet përmbajtja e faqes web :

```
html>
  <head>
    <title> Une mesoj HTML </title>
  </head>
  <body>
    Ky eshte nje rresht tekst.
  </body>
</html>
```

Nqs kodet e mësipërme i ruajmë si libri.html dhe filen e hapim me browser do të marrim rezultatin e mëposhtëm :



Titulli i faqes është i rëndësishëm pasi përdoret nga motorët e kërkimit për identifikimin e faqeve web.

## Elementi <p>


Ky tag përdoret për krijimin e një paragrafi,

Sintaksa:

```
<html>
  <head>
    <title>Une mesoj HTML </title>
  </head>
  <body>
    <p>Ky eshte paragraf </p>
    <p>Ky eshte paragraph </p>
  </body>
</html>
```

**Rezultati:**

---



Browsers automatikisht shtojnë një rresht bosh pas një paragrafi.

---

## Thyrja e rreshtit

Tagu vetëmbyllës `<br/>` përdoret për kalimin në një rresht të ri ose shtimin e një rreshti bosh.


```
<html>
  <head>
    <title>Une mesoj HTML</title>
  </head>
  <body>
    <p>Ky eshte paragraf.</p>
    <p> Ky eshte paragraf.</p>
    <p>Ky eshte <br /> tagu qe perdoret per thyerje rreshti </p>
  </body>
</html>
```

Tagu `<br/>` nuk ka nevojë për tag mbyllës.

**Rezultati:**

---






## Elementet e formatimit

Në html është është një listë me element të stileve specifike të paraqitjes së formatit tekstit.

Elementët e formatimit shërbejnë për praqitjen e tipeve të ndryshme të tekstit:

```
<html>
<head>
  <title>Elementet e Formatimit</title>
</head>
<body>
  <p>Ky është tekst i rregullt </p>
  <p><b> text i errët </b></p>
  <p><big> Tekst i zmadhuar </big></p>
  <p><i> Teksti i pjerrët </i></p>
  <p><small> Tekst i zvogëluar </small></p>
  <p><strong> strong text </strong></p>
  <p><sub> subscripted text </sub></p>
  <p><sup> superscripted text </sup></p>
  <p><ins> Tekst i nënvizuar </ins></p>
  <p><del> Tekst i fshirë </del></p>
</body>
</html>
```

**Rezultati:**



## HTML Headings( Kreu)


HTML përfshin gjashtë nivele të headings, të cilat janë radhitur në varësi të rëndësisë.

Të cilat janë : `<h1>`, `<h2>`, `<h3>`, `<h4>`, `<h5>`, dhe `<h6>`.

Në kodin e mëposhtëm janë paraqitur të gjithë headings:

```
<html>
  <head>
    <title>Headings </title>
  </head>
  <body>
    <h1> heading 1</h1>
    <h2> heading 2</h2>
    <h3> heading 3</h3>
    <h4> heading 4</h4>
    <h5> heading 5</h5>
    <h6> heading 6</h6>
  </body>
</html>
```

## Rezultati:



Nuk rekomandohet që headings të përdoren thjesht për të bërëë textin big ose bold, sepse motorët e kërkimit i përdorin ato për indeksimin e strukturës dhe përmbajtjes së faqeve web.

## Vija Horizontale

Për të krijuar vija horizontale, përdoret tagu `<hr />` .

```
<html>
  <head>
    <title>Headings dhe Vijat Horizontale </title>
  </head>
  <body>
    <h1> heading 1</h1>

<hr/>
    <h2> heading 2</h2>
    <h3> heading 3</h3>
    <h4> heading 4</h4>

<hr/>
    <h5> heading 5</h5>
    <h6> heading 6</h6>
```

```
</body>  
</html>
```

## Rezultati:



## Komentet

Komentet nuk shfaqen në browser, por ndihmojnë në dokumentimin e HTML duke shtuar përshkrime, shënime të ndryshme që shpjegojnë strukturën e kodit.

## Sintaksa :


```
<!--Ky eshte koment -->
```

## Example:

```
<html>
  <head>
    <title>Koment </title>
  </head>
  <body>
    <p>Ky eshte paragraf </p>
    <hr />
    <p>Ky eshte paragraf </p>
    <!--Ky eshte koment -->

  </body>
</html>
```

### Rezultati:



Siç e shikoni komentet nuk shfaqen në browser.

## Atributet HTML


Atributet sigurojnë informacion shtesë përreth një elementi ose tagu, si edhe realizon modifikimin e tyre. Shumica e atributëve kanë një vlerë; vlera modifikon atributin.

```
<p align="center">
  Ky tekst do te shfaqet ne qender
</p>
```

Ne shembull vlera "center" e atributit i tregon browserit që tekstin e paragrafit ta shfaqë në qendër.

Atributet specifikohen gjithmonë në tagun hapës, në trajtën **name="value"**.

### Rezultati:




## Atributi Align

Ky atribut përdoret për pozicionimin e tekstit .

Në shembull më poshtë , kemi një paragraph që është pozicionuar në qendër , dhe një vijë që është pozicionuar në të djathtë:

```
<html>
<head>
  <title>Atributet</title>
</head>
<body>
  <p align="center">Ky eshte tekst <br />
    <hr width="10%" align="right" /> Ky eshte tekst gjithashtu.
  </p>
</body>
</html>
```

## Rezultati:



## Tag-u <img>

Tagu **<img>** përdoret për insertimin e imazheve. Përmban vetëm attribute dhe nuk ka tag mbyllës.

URL-ja (adresa) e imazhit përcaktohet duke përdorur atributin **src** .

Sintaksa e imazhit HTML :

```

```

Për shembull , nqs kemi një foto me emrin "gjethe.jpg" në të njëjtin folder me filen HTML, kodi juaj do të duket kështu:

```
<html>
  <head>
    <title>first page</title>
  </head>
  <body>
    
  </body>
</html>
```

Në rast se imazhi nuk mund të shfaqet , atributi alt specifikon një tekst alternativ që përshkruan imzhin me fjalë.

---

## Përmasat e imazheve

Për përcaktimin e përmasave të imazhit përdoren atributet width dhe height.

Figura mund të specifikohet në **pixels** ose **perqindje**:

```
<html>
<head>
  <title>Përmasat e Imazheve </title>
</head>
<body>
  
  <!-- ose -->
  
</body>
</html>
```

## Korniza e imazhit

Paraprakisht , një imazh nuk ka kornizë. Për të krijuar një kornizë përreth imazhit përdoren atributi border:

```

```

Gjithashtu ngjyra e kornizës mund të ndryshohet:

```

```

Paraprakisht, broseri Internet Explorer 9, dhe versionet e tij, shfaqin imazhin me kornizë edhe pse nuk është specifikuar si atribut.

## Tagu <a>

Linket janë pjeësë shumë e rë ndësishe e faqeve web. Ju mund të shtoni link një imazhi ose një teksti i cili mundëson kalimin në faqe tjetër web pasi të klikoni mbi të. Për përcaktimin e adresës së faqes web përdoret atributi **href** :

```
<a href=""> </a>
```



Në shembullin më poshtë , përcaktohet një link që hap faqen e google:

```
<a href="www.google.com"> Google </a>
```

---

## Atributi target

Atributi **target** tregon se ku do të lidhet dokumenti që do të lidhet.

Nqs i japim vlerën **\_blank** këtij atributi do të marim një link që do të hapqet në një dritare te re tab në browser:

```
<a href="www.google.com" target="_blank">  
  Google  
</a>
```


---

## Listat e Radhitura

Një listë e radhitur fillon me tagun **<ol>** dhe përcakton secilën njesi duke përdorur tagun **<li>** .  
Më poshtë paraqitet një shembull i një liste të radhitur:

```
<html>  
<head>  
  <title>Listat e Radhitura</title>  
</head>  
<body>  
  <ol>  
    <li>Kompjuter </li>  
    <li>Telefon </li>  
    <li>Tablet</li>  
  </ol>  
</body>  
</html>
```

**Rezultati:**



---

## Listat e paradhitura

Një listë e paradhitur fillon me tagun `<ul>` dhe përcakton secilën njesi duke përdorur tagun `<li>`.

Më poshtë paraqitet një shembull i një liste të paradhitur:

```
<html>
  <head>
    <title>Listat e Radhitura</title>
  </head>
  <body>
    <ul>
      <li>Kompjuter </li>
      <li>Telefon </li>
      <li>Tablet</li>
    </ul>
  </body>
</html>
```

---

## Tabelat në HTML

Tabelat në HTML janë shumë të rëndësishme. Ato ndërtohen duke përdorur tagun kryesor

< table >. Tabelat përbëhen nga rreshta të cilët ndërtohen me tagun <tr>. Rreshtat e tabelave ndahen në qeliza të cilët shkruhen me tagun < td > nga gjuha angleze (table data).Të dhënat e tabelave mund të jenë tekst, imazhe, tabela të tjera, lista etj. Më poshtë paraqitet ndërtimi i një tabelle me një rresht dhe tre kolona:

```
<html>
<head>
  <title>Këtu shkruhet titulli i dokumentit web</title>
</head>
<body>
  <table>
    <tr>
      <td>qeliza në kolonën e parë</td>
      <td>qeliza në kolonën e dytë </td>
      <td>qeliza në kolonën e tretë </td>
    </tr>
  </table>
</body>
</html>
```

#### - **Atributi *border* dhe *colspan* në Tabela**

Një kornizë/border në tabelë mund të vendoset duke përdorur tagun < table border="2" > ku vlera është 2 *pikesla*.Një qelizë tabelle mund të jetë bashkim i dy ose më shumë kolonave duke përdorur atributin < colspan > . Por për formatimin e tabelave përdoren edhe shumë attribute të tjera.

Për shembull rasti kur njëra prej qelizave është bashkimi i dy kolonave :

```
<html>
<head>
  <title>Këtu shkruhet titulli i dokumentit web</title>
</head>
<body>
  <table border="2">
    <tr>
      <td>qeliza në kolonën e parë</td>
      <td>qeliza në kolonën e dytë </td>
      <td>qeliza në kolonën e tretë </td>
    </tr>
    <tr>
      <td><br/></td>
      <td colspan="2"></td>
    </tr>
  </table>

</body>
</html>
```

## Krijimi i formave në HTML


Ndërfaqja kur logoheni në një faqe të caktuar web është e ndërtuar nga elemente HTML që quhen forms. Format në HTML përdoren për marrjen e informacioneve nga përdoruesit. Ato ndërtohen duke përdorur tagun kryesor < form >.

Ato shkruen brenda tageve < body > < / body >.

Për shembull forma e mëposhtëme kërkon nga përdoruesi të dhëna si emri, mbiemri dhe password-i:

```
<html>
  <head>
    <title>Ketu shkruhet titulli i dokumentit web</title>
  </head>
  <body>
    <form>
      Emri: <input type="text" name="emri"/><br/><br/>
      Mbiemri: <input type="text" name="mbiemri"/><br/><br/>
      Password :<input type="password" name="password"/><br/><br/>
      <input type="submit" value="Dergo"/>
    </form>
  </body>
</html> </html>
```

## Rezultati:



Ketu shkruhet titulli i doku x

file:///C:/Users/user1/Desktop/libri.html

Emri:

Mbiemri:

Password :

Dergo

Elementi `<input>` merr attribute të ndryshme në varësi të dhënave input si radio, text, tel, e-mail, number, submit, url etj. Pasi të dhënat merren nga përdoruesi, procesohen në server duke përdorur një gjuhë tjetër programimi që quhet PHP.

## Ngjyrat në HTML!

Ngjyrat në HTML shprehen në vlera hexadecimal.


**0, 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, A, B, C, D, E, F**

Siç e shikoni, janë 16 vlera, 0 deri tek F. Zero tregon vlerën më të vogël, dhe F vlerën më të lartë

## Modeli i ngjyrave në HTML

Ngjyrat shprehen si kombinim i dritës së ngjyrave **red**(të kuqes), **green**(të gjelbërtës), dhe **blue**(blusë) (**RGB**).

Vlerat hexadecimal shkruhen duke përdorur hashtag (#), ndjekur nga tre vlera ose 6 vlera hexadecimal.



Nga kombinimi i tyre krijohen rreth 16 billion ngjyra!

---